




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2 D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-2916/15</u>
Nr. I faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>28-09-2015</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.09.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2513-15 për *znj. Majlinda Hajrullahu – Anëtare e Bordit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë znj. Hajrullahu ka mbaruar mandatin dhe nuk ushtron më funksioni të zyrtarit të lartë publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2513-15, për Zyrtaren e lartë, znj. Majlinda Hajrullahu – Anëtare e Bordit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), dhe njëkohësisht person i autorizuar i biznesit privat “Digital-MI” n.sh., është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj. Hajrullahu fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ajo ka qenë në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast, ka njoftuar se ajo me nuk është ne mesin e zyrtarëve të lartë publik sepse i ka skaduar mandati ligjor në këtë funksion.

Largimin nga funksioni publik znj. Hajrullahu pastaj e ka konfirmuar edhe me formularin e deklarimit të pasurisë të cilin në Agjencinë kundër Korrupsionit e ka dorëzuar me dt. 23.09.2015 me numër protokoli DP-03-4586/15.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore e Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

